

## **Bajram (Ukë) Muslijaj**

(6.11.1969, shqiptar nga Shaptej/Šaptelj, komuna e Deçanit/Dečani, punëtor ndërtimor, pjesëtar i UÇK-së)

## **Azem (Ukë) Muslijaj**

(10.06.1972, shqiptar nga Shaptej/Šaptelj, komuna e Deçanit/Dečani, punëtor në hoteleri, pjesëtar i UÇK-së)

## **Rifat (Ibër) Beqiraj**

(15.03.1976, shqiptar nga Shaptej/Šaptelj, komuna e Deçanit/Dečani, i papunë, pjesëtar i UÇK-së)

Vëllezërit Shemsiu, Bajrami dhe Azemi, si dhe komshiu i tyre Rifati, u bënë anëtarë të UÇK-së në fillim të konflikteve në Kosovë. Detyra e tyre ishte që pjesëtarë të UÇK-së, të cilët vinin nga Shqipëria, t'i përcillnin deri në fshatin Ratish/Ratiš. Ishin të stacionuar në një shtëpi në lagjen *Shavare*, në **Gramaçel/Gramočelj**. I fundit që i kishte takuar Shemsium, Bajramin dhe Rifatin, ishte vëllai i tyre i vogël, Bashkimi. Kjo ka ndodhur në mëngjesin e datës **9. 05. 1998**, kur Bashkimi u ka dërguar ushqim. Ditën tjetër, Bashkimi dhe vëllai më i madh i viktimize, Osmani, i kanë gjetur trupat e tre vëllezërve të tyre dhe atë të Rifat Beqirajt. Të gjithë ishin qëlluar nga armë zjarri dhe kishin plagë të shumta. Pas dy javësh, më 23.05.1998, Bashkimi dhe afro njëzet bashkëfshatarë kanë shkuar për t'i marrë kufomat. I kanë varrosur në pyllin *Gojan*, që gjendet përkaj fshatit. Një vit më vonë, mbetjet mortore të Shemsit, Bajramit, Azemit dhe Rifatit janë rivarrosur në varrezat e fshatit Shaptej/Šaptelj.

**Burimet:** deklarata B.M, FDH-19229; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

## **Dragoljub (Mladen) Ristić**

(3.02.1955, serb nga Beogradi, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Dragoljubi, i quajtur Švaba, e ka mbaruar kursin për oficer policie në vitin 1978. Menjëherë u punësua në Sekretariatit e Punëve të Brendshme të Beogradit. Me bashkëshorten Dragicen, djalit Slavišën dhe vajzen Sanjen jetonte në lagjen *Bregu i Bezhanisë*, në një banesë që e mori nga

MPB-ja e Serbisë. Pas fillimit të konflikteve në Kosovë, ai u transferua në zonën e fshatit **Baballoq/Babaloc**. Më **10.05.1998**, nga ora 17:00, Dragoljubi u nis për t'i ndihmuar kolegut për të riparuar një top gjuajtës. Duke lëvizur drejt tij, ai u qëllua nga një pushkë snajperi. E çuan menjëherë në spitalin e Prishtinës/Priština, ku mjekët konstatuan vdekjen e tij. Dragoljubi u varros në varrezat lokale të vendlindjes në Potočić, më 12.05.1998.

**Burimet:** deklarata R.R, FDH-25912; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 61; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 9.

## **Lan (Metë) Dobraj**

(1918, shqiptar nga Gramaçeli/Grmočelj, komuna e Deçanit/Dečani, këngëtar, dhjetë fëmijë)

## **Ukë (Bajram) Beqiraj**

(1924, shqiptar nga Shaptej/Šaptelj, komuna e Deçanit/Dečani, punëtor arsimor, dy fëmijë)

## **Bekë (Sadri) Muslijaj**

(15.05.1941, shqiptar nga Shaptej/Šaptelj, komuna e Deçanit/Dečani, punëtor arsimor, gjashtë fëmijë)

Forcat serbe kanë depërtuar në fshatin Shaptej/Šaptelj në orët e hershme të mëngjesit, në datën **10.05.1998**. Beka mori vendim të qëndronte në fshat me djalit Muhametin, ndërkaq bashkëshortja dhe dy vajzat e tij e braktisën shtëpinë dhe u strehuan në një pyll të afërt, ku kanë qëndruar për 64 ditë rresht. Në ditët në vijim, Beka dhe Muhameti kaluan në fshatin fqinj të Gramaçelit/Gramočelj. Në datën 10.05.1998, Beka, Ukë Beqiraj dhe Lan Dobraj u nisën për në Shaptej/Šaptelj, me qëllim që të provonin t'i tërhiqnin trupat e pajetë të tre djemve të vëllait të Bekës dhe të një i riu nga Gramaçeli/Gramočelj [të shikohet regjistrimi]. Nuk u kthyen nga ky aksion. Për fatin e tyre nuk dihej asgjë për disa muaj. Më 1.07.1998, një bari i zbuloi trupat e Bekës, Lanit dhe Ukës në pyllin pranë varrezave të fshatit **Shaptej/Šaptelj**. Të gjithë u varrosën në varrezat e fshatit Shaptej/Šaptelj më 2.07.1998.

**Burimet:** deklarata A.M, FDH-19250; deklarata B.M, FDH-19229.